



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:019635
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05867671

CAP.nr.1057/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve E.M, S.A, M.D, K.P, N.P që të gjithë nga Mitrovica e të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Av. SH.A dhe Av.L.A nga Mitrovica, kundër debitorit Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson Avdyl Beqiri duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.26/2023, i datës 31.05.2023 me datë 27.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” në Mitrovicë, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.26/2023, i datës 31.05.2023 dhe çështja kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosije.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë –Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin CP.nr.26/2023, i datës 31.05.2023 ka vendosur si në vijim:

“I.REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” në Mitrovicë, ushtruar kundër aktvendimit për lejiin e përmbartimit Cp.nr.57/2020 i datës 20.02.2020 sipas propozimit të kreditorëve E.M, S.A, M.D, K.P, N.P që të gjithë nga Mitrovica.

II.OBLIGOHET debitori Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” në Mitrovicë që kreditorëve në emër të borxhit për pagesën e të ardhurave personale të ju paguaj shumat si në vijim: 1) E.M, shumën prej 2,891.31euro. 2) S.A, shumën prej 2,891.31euro. 3) K.P, shumën prej 4,799.43euro. 4) N.P, shumën prej 4,799.43euro. 5) M.D, shumën prej 4,799.43euro, me kamatë prej 8%, në afat prej 15 ditësh, nga dita pranimit të këtij aktvendimi.

III.APROVOHET PJESËRISHT kërkesa e kreditorëve lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore ashtu që OBLIGOHET debitori që kreditorëve të ju paguaj shumën prej në lartësi prej 1,747.20euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita pranimit të këtij aktvendimi, ndërsa REFUZOHET PJESËRISHT kërkesa për kompensimin e shpenzimeve procedurale përbarimore mbi shumën e aprovuar dhe atë për shumën 405.60euro si e pabazuar.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t’i kthehet Gjykatës Themelore në rishqyrtim dhe rivendosje .

Përgjigje në ankesë kanë parashtruar kreditorët përmes të autorizuarit të tyre, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorët me datën 03.02.2020, kanë paraqitur propozim për përbarim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në bazë të dokumentit përbarimor – Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nr.A 02/193/2016, i datës 20.07.2016.

Gjykata me aktvendimin, CP.nr.57/2020, i datës 20.02.2020 e ka lejuar përbarimin e vendimit të KPMSHCK-së.

Kundër këtij aktvendimi pala debitore brenda afatit të përcaktuar ligjor ka parashtruar prapësim me të cilin ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet aktvendimi për caktimin e përbarimit.

Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin, Cp.nr.57/2020, i datës 27.08.2020 me të cilin e ka refuzuar në tërësi të pa bazuar prapësimin e debitorit, duke e lënë në fuqi aktvendimin e Gjykatës me të cilën është lejuar përbarimi.

Pala debitore i pa kënaqur me vendimin e Gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e cila me aktvendimin, Ac.nr.4410/2020, i datës 23.12.2022 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit duke e prishë aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë dhe duke e kthyer lëndën të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Pas kthimit në rivendosje, Gjykata Themelore në Mitrovicë –Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin, CP.nr.26/2023, i datës 31.05.2023 e ka refuzuar prapësimin duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se pas administrimit të provave, ka konstatuar se dokumenti përmbarues Vendimi A/02/193/2016 i datës 20.07.2016 i KPMSHCK-së, është dokument i cili është i përshtatshëm për përmbarim, të cilin debitori nuk e ka përmbushur – përmbaruar në tërësi në mënyrë vullnetare, andaj edhe prapësimi i të njëjtës është tërësisht i pabazuar. Tutje ka shtuar se ka vërtetuar faktin se debitori ka nxjerr Rregulloren për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” nr.325/005 të datës 09.03.2017, mirëpo sipas ekspertizës financiare rrjedh se debitori nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin që ka pasur sipas dokumentit përmbarues i cili është objekt i kësaj çështje përmbarimore.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se sipas Vendimit A/02/193/2016 të datës 20.07.2016 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka vërtetuar faktin se me këtë vendim është pranuar ankesa nr. A/02/193/2016 e datës 23.05.2016 e këtu kreditorëve E.M, S.A, M.D, K.P, N.P etj dhe është obliguar Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit Publik “Isa Boletini” në Mitrovicë, që nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr akt administrativ me të cilin ankuesve ua njih ngritjen në pagën bazë nga data 21.04.2016 konform Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/151 të datës 06.01.2011 dhe Vendimit të Qeverisë nr.03/177 të datës 14.03.2014. Tutje ka theksuar se, debitori nuk e ka përmbaruar vendimin e lartcekur sa i përket pjesës që ka të bëjë me ngritjen e pagës bazë konform Vendimit të Qeverisë nr.02/151 të datës 06.01.2011, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e obliguar debitorin që ti paguaj kreditorëve shumat sikur në pikën II të dispozitivit në mënyrë që obligimit ndaj kreditorëve të përmbushet në tërësi. Vendimi i KPMSHCK-së është dokument përmbarues i cili mund të ekzekutohet dhe obligimi ndaj secilit kreditor është caktuar në bazë të ekspertizës financiare të ekspertit Mujë Ferati. Në bazë të kësaj ekspertize financiare të cilës gjykata i’a fali besimin e plotë, gjykata ka konstatuar se në pagën bazë të vitit 2011 është dashur të aplikohet rritja prej 30% që të krijohet baza e re dhe me këtë bazë të vazhdoen pagesa në muajt në vijim, ndërsa në vitin 2014 nga paga bazë e re e krijuar pas rritjes prej 30% është dashtë të implementohet edhe rritja e dytë prej 45% kështu që krijohet baza e re, bazë në të cilën është dashtë të bëhet pagesa e pagave sipas muajve në vijim kështu që debitorit ka qenë i obliguar që së pari ta aplikoj rritjen e pagës bazë sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/151 të datës 06.01.2011 dhe Vendimit nr.03/177 të datës 14.03.2014, e më pastaj të bëhet unifikimi ose nivelizimi i pagave.

Sa i përket pretendimit të debitorit se vendimi i KPMSHCK nr. A/02/193/2016 i datës 20.07.2016, është ekzekutuar nga gjykata në procedurën përmbarimore sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë CP.nr.236/2016, Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se është i pa bazuar sepse ky aktvendim e ka ekzekutuar obligimin e debitorit ndaj kreditorëve për periudhën nga data 21.04.2016 e deri më datën 31.12.2017, ndërsa kreditorët me propozimin për përmbarim Cp.nr.57/2020 të datës 03.02.2020, i cili propozim është lejuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë Cp.nr.57/2020, kanë kërkuar që të përmbarohet obligimi i debitorit ndaj kreditorëve për periudhën 01.01.2018 e deri në ditën e nxjerrjes së ekspertizës, pra nuk është kërkuar përmbarimi për periudhën e njëjtë kohore për të cilën është vendosur me Aktvendimit e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CP.nr.236/2016. Këtë fakt e pohon edhe përfaqësuesi i Universitetit në fjalën e tij gjatë seancës dëgjimore i cili thekson se *“në procedurën përmbarimore është bërë ekzekutimi i dhunshëm i mjeteve financiare për kreditorët për periudhën nga 21.04.2016 deri më 31.12.2017.”*

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur komfor nenit 13 paragrafi 6 i Ligjit për procedurën përmbarimore lidhur me nenin 454 paragrafi 1 i LPK-së dhe në bazë të Rregullores për Tarifat e Avokatëve të datës 18 mars 2017, duke obliguar debitorin që kreditorëve të ju kompensoj shumën në lartësi prej 811.20 euro për përfaqësim në dy seanca dhe shumën prej 936.00 euro për përpilimin e propozimit për përmbarim, ndërsa është refuzuar kërkesa për pagesën e shumës prej 405.60 euro, për arsye se seanca nuk është mbajtur.

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar, ka vendosur në bazë të nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 i LMD-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar është marrë më shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, respektivisht nenit 182 par.1 të LPK-së, nenit 17 e lidhur me nenin 49 të LPP-së, e cila ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Qëndrojnë pretendimet ankimore se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse me aktvendimin me të cilin është lejuar përmbarimi nga Gjykatës së shkallës së parë është bërë tejkalimi i vëllimit të detyrimit ndaj debitorit, dhe kjo paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e cila në mënyrë analoge zbatohet edhe në procedurën përmbarimore në kuptim të nenit 17 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se, nga shkresat e lëndës shihet se, me vendimin administrativ të KPMSHC me të cilin është detyruar pala debitorë që kreditorëve t'ua njeh ngritjen në pagën bazë nga data 21.04.2016, konform Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.02/151, i datës 06.01.2011 dhe vendimit nr.03/177, i datës 14.03.2014, në dispozitiv të këtij aktvendimi nuk është detyruar debitori që të paguajë ndonjë shumë, por vetëm të bëhet ngritja e pagave sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Po ashtu qëndrojnë pretendimet ankimore se, gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që përmes ekspertizës financiare ka përcaktuar

lartësinë e kompensimit që ju takon kreditorëve për periudhën kontestuese në emër të rritjes së pagës bazë sipas vendimeve të Qeverisë, e që sipas kësaj gjykate nuk është e qartë se mbi çfarë baze është caktuar ekspertiza financiare sepse, në rastin konkret caktimi i ekspertizës nuk përbënë bazë për lejimin e përmbarimit, sipas dispozitave të LPK-së ekspertiza financiare caktohet vetëm kur shuma është kontestuese e që në rastin në fjalë nuk mund të kuptohet a është vendosur sipas propozimit për përmbarim apo është zgjidhur çështja kontestuese, e jo propozimi për përmbarim sipas rregullave të procedurës përmbarimore.

Kjo gjykatë vlerëson se, Gjykata e shkallës së parë bazuar në provat që i ka pasur në dispozicion, nuk ka vepruar sipas dokumentit përmbarimor vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, po ashtu nuk ka marrë për bazë njoftimin se debitorit në mënyrë vullnetare e ka realizuar vendimin e KPMSHCK ashtu që paga bazë e punëtorëve është rritur mbi 50% dhe është realizuar përmes mënyrës alternative duke bërë shkrirjen e stimulimit në pagën bazë. Në shkresa të lëndës gjendët njoftimi se debitori duke vepruar sipas vendimit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me shkresën e datës 30.11.2020 ka njoftuar se është zbatuar nga Universiteti i Mitrovicës, fakt ky i cili nuk është marrë për bazë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Me dispozitën e nenit 49 të LPP-së parashihet që: *“Përmbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarimin apo urdhrin për përmbarim”*, në këtë rast përmbarimi duhet të kryhet në harmoni të plotë me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A/02/193/2016 të datës 20.07.2016, në bazë të së cilit është paraqitur propozimi për përmbarim. Kjo gjykatë sqaron se, Aktvendimi për përmbarim apo urdhri përmbarimor duhet të jetë ne tersi i njëjtë me dokumentin i cili paraqitet si titull përmbarimor dhe i cili i bashkëngjitet propozimit për përmbarim, ndërsa gjykata me rastin e zbatimit të përmbarimit duhet të ketë parasysh që në asnjë mënyrë të mos bëjë tejkalim të vëllimit të detyrimit të debitorit, në rastin konkret gjykata ka qenë e obliguar që lejimi i përmbarimit të behët sipas dokumentit përmbarimor respektivisht vendimit të Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A/02/193/2016 të datës 20.07.2016.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë udhëzohet që të eliminojë shkeljet e lartcekura, fillimisht të veproj konform nenit 199 të LPK-së, sipas vërejtjeve të dhëna me Aktvendimin Ac.nr.4410/2020 i datës 23.12.2022, ashtu që të vlerësoj edhe njëherë vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A-02-193-2016 të datës 20.07.2016, në atë mënyrë që të vlerësoj se çfarë obligimi ka Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit Publik “Isa Boletini” në Mitrovicë, pra a ka për obligim të nxjerr aktin administrativ me të cilin ankuesve ua njej ngritjen në pagë pazë nga data 21.04.2016, konform vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/151 të datës 06.01.2011, dhe vendimit nr.03/177 i datës 14.03.2014, apo ka të drejtë që të paguaj shumat kreditorëve sipas ekspertizës financiare dhe kamatë ligjore prej 8%. Gjykata me rastin e vendosjes duhet të vlerësoj edhe pretendimet ankimore të debitorit, e pastaj të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Andaj, Gjykata e Apelit të Kosovës në bazë të dispozitës së nenit 209 par.1 pika d të LPK-së dhe nenit 3 par.2 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:019635
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05867671

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1057/2023, me datë 27.06.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj, d.v.